1.5.2

VATRA E RINIS
**Revistë për Fëmijë**

Tiranë, me 31 Maj 1936

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ
ΑΡΧΕΙΟ ΕΥΛΟΓΙΟΥ ΚΟΥΡΙΛΑ
Αρ. Εγγρ.: 4111

I nderuar dhe i dashur im Lengj,

Pardje mora letrën t'uaj dhe u-habita — e u-gëzova njëherësh — kur pashë se qe përgjigje e letrës s'ime. Arrijti këtu në dy dit! Për punën e Kishës nuk më jepni përgjigje mjaft të çkoqur, por kuptohet se ju e lini të vendosë dëshira e t'interesuarvet. Si parim fare mirë. Nuk i kam parë akoma migt që përmendni, por do t'a gjenj rastin këto dit të flas si me 'to ashtu dhe me të tjerë. Por nga sa kuptonj flitet më shumë për të tjera emra kandidatesh tashi. Hë-për-hë u-përfundua që Kryesinë e Kishës t'a mbajë si Zëvendës Episkopi i Korçës Imzot Kisi (me të cilin pata pjekje dje) dhe nesër e merr në dorëzim. Më von do bëhet zgjedhja ose emërimi i Kryetarit definitiv.

Me Imzot Vissarionin u-pashë prap dje dhe bisedova sido q'isha i bindur se s'kish rast për proponimin t'uaj. Ay thotë tashi dua të shpërlodhem, mjaft jam lodhur e s'kam moshë për punëra të reja. Dhe e vërteta është se atij i sigurohet mirë jetesa këtu dhe pas dorëheqjes. Ka punuar më me mend se sa kujtoni ju. Ay ka blerë (ka një vit) një shtëpi me ca mall, si çiflik, jashtë Tiranës, jo larg, një ἡσυχαστήριον të vërtetë. Dhe shteti duke ja njohur shërbimet patriotike po i cakton një rrogë prej 500 frangash në muaj. E, ç' i duhet atij ahere të çajë kokën për të blerë dhe për drejtuar Institute ose shkollà andej? Ju falet nderit juve dhe ju dërgon përshëndoshje vllaznore.

Kjo besonj se nuk ua prish pllanin që kini për atë shkollë. Mund të gjeni të tjerë shokë, mbassi merrni pjesën t'uaj. Dhe sa për vajtjen t'ime besonj se nuk d'ish varur puna që të mbështetëshim në shoqërinin me Xhuvanin. Açë gjë e kini ju në dorë. Ca më tepër mbassi qenki drejtor i shkollës. Sido qoftë, pres një përgjigje të saktë për këtë që të di si të bënj. Në mos paça fatin e përkrahjes s'uaj, ahere t'i bënj çarë kokës e të përpiqem këtej; por këtej unë kam qëllim të përpiqem për daljen

ΒΙΒΛΙΟΘΗΚΗ ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟΥ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ

Andonaqui i cili sivjet mbaron fillloren dhe mot duhet te hyjë ne Gjimnaz ose ne Licé.

Unë po përpiqem te jetoj me revisten e vogel "Vatra e Rinis" dhe me nga nonjë libre kohe me kohe. Ju ç'libra kini botuar ose botoni tashi? Nga librat t'uaja vetem atë "Αλβανικαί Μελέται" kam. Ju kisha derguar një liste për disa libra. S'që e mundur te m'a plotësonit atë deshirë? ..

Po ju dergonj me poste veçanerisht dy numura te gazetes "Arbenia" ku botohet Deklarata e Kryepiskopit Vissarion mbi dorëheqjen e tij.

Nga shendeti jemi mirë dhe nga fshati kam marrë letra, mirë janë, vetem pak varfëri kanë. Kohërat t'atillo. Pergjithërisht punët janë mirë ne vendin t'onë. Qetësi dhe përpjekje për përparim.

Ime-shoqe dhe femija ju puthin dorën. Besonj se nuk do me lini pa përgjegje.

Nipi juaj

Vthaçe

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΑΚΗ ΒΙΒΛΙΟΘΗΚΗ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ